



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 970/1 prot.,

Datë 15.04.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”, përfaqësuar nga JAN DE NUL NV, në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar - mbi kufirin e larte monetar (me mjete elektronike)” me nr. REF-34376-12-23-2024, me objekt: “Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano – Faza I”, me fond limit 39.320.000.000 (tridhjetë e nëntë miliardë e treqind e njëzet milionë) Lekë, pa TVSH; 399.674.730,64 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër) Euro pa TVSH. * Kursi zyrtar i këmbimit, sipas Bankës së Shqipërisë, në datën 23.12.2024 është 98.38 Lekë/Euro, zhvilluar me datë 07.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”, përfaqësuar nga JAN DE NUL NV, me NIPT BE0406.041.406 dhe adresë Tragel 60, Hofstade-Aalst, Belgium, B-9308.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës me adresë Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Në datën 14.04.2025 është dorëzuar dorazi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa me numër 970/2025 prot., datë 14.04.2025 e BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Arsyet e skualifikimit janë mosgjetja, në dokumentacionin e paraqitur, të vërtetimit të punimeve të kryera për projektin “NRL – Echangeur & Diques; La Nouvelle Route du Littoral – La Réunion” ku të specifikohet përqindja e pjesëmarrjes në projekt të secilit pjesëmarrës, duke qenë se, projekti është realizuar nga një Joint Venture (J.V.). Gjithashtu, autoriteti njofton se Komisioni për Vlerësimin e Ofertave (KVO) nuk ka gjetur në dokumentacion, formularin e vlerësimit ose aktin e kolaudimit dhe/ose certifikatën e marrjes në dorëzim”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 15.04.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini	Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri